



Republika e Kosovës – Republika Kosova
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

Anr. 569/2021

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia (PZAP), i përbërë nga gjyqtarët: Adnan Konushevci, kryesues, Rustem Thaqi dhe Faton Ademi anëtarë, me pjesëmarrjen e zyrtares ligjore Blerta Peci, duke vendosur përkitazi me apelin e parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK), me seli në Ferizaj, paraqitur kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me datë: 14.02.2021, në seancën e panelit të mbajtur me 05.03.2021, mori këtë:

V E N D I M

REFUZOHET i pabazuar apeli i parashtruar nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK), me seli në Ferizaj, kundër vendimit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve (KQZ), Nr.860/2021 të datës 04.03.2021, për Zgjedhjet e Parakohshme për Kuvend të Kosovës të mbajtura me datë: 14.02.2021, me të cilin ka kërkuar rinumërimin e votave me kusht në tërë Komunat e Kosovës.

A r s y e t i m

PZAP-i, ka pranuar një apel me datën 04.03.2021 në ora 15:30, nga subjekti politik Partia Demokratike e Ashkalive të Kosovës (PDAK), me seli në Ferizaj, duke pretenduar se ka parregullsi në numërimin e votave me kusht në të gjitha komunat e Kosovës.

Parashtruesi i apelit ka kërkuar nga PZAP-i, që të rinumrohen votat me kusht në të gjitha komunat e Kosovës.

PZAP-i, pas shqyrtimit paraprak të besueshmërisë së ankesës dhe vlerësimit të pretendimeve ankimore, që gjenden në shkresat e lëndës, në kuptim të nenit 117 paragrafi 2 dhe 3 të LZP-së, gjeti se:

Apeli është i pabazuar

PZAP-i, konstatoi se pretendimet ankimore janë të pabazuara ngase parashtruesi i apelit kërkon që të rinumrohen votat me kusht në të gjitha komunat e Kosovës. Mirëpo, pretendimet në apel me asnjë provë bindëse nuk i ka dëshmuar se në cilat vendvotime janë bërë parregullsi, ashtu siç pretendon, prandaj lidhur me këtë çështje PZAP-i, apelin e parashtruar e konsideron si të përgjithshëm dhe të pa bazuar konform dispozitës ligjore të nenit 117 i Ligjit nr. 03/-073 për Zgjedhjet e Përgjithme në Republikën e Kosovës.

Prandaj, PZAP-i, konstatoi se pretendimet në apel janë të pabazuara ngase parashtruesi i apelit nuk ka ofruar asnjë dëshmi për t'i vërtetuar dyshimet e tij të pretenduara në apel edhe pse barra e te provuarit bie mbi parashtruesin e apelit, po ashtu nuk ka dhënë asnjë udhëzim apo hollësi se ku mund të gjenden dëshmitë, të cilat nuk i ka pasur në posedim lidhur me atë çka pretendon në ankesë.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në nenin 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, paneli, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrësia

Anr.569 /2021 më datën 05.03.2021

Kryesuesi i Panelit
Adnan Konushevc

Këshilla Juridike: Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par.4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.